



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA —DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktoriat za Poljoprivreda, Sumarstvo, Inspekciju, Turizam i Ruralni Razvoj

09.Nr.323/01-13460/24

Dt. 19.06.2024

Dragash

Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural, bazuar në Vendimin e kyetarit të Komunës me numër 02.Nr.323/01-13460/24, të datës 19.06.2024, si dhe duke u bazuar në Rregullorën Komunale nr. 01Nr.060/01-31587/1 të datës 24.12.2019 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së subvencioneve, shpall këtë:

Thirrje publike

Organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, e që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar me aktivitete në përkrahje dhe ruajtje te racës se qenit ilir - qenit të Sharrit, të aplikojnë për mbështetje financiare për organizimin e aktivitetit:

EKSPOZITA E RACËS SË QENIT ILIR - TË SHARRIT

Qëllimi i organizimit të kësaj ekspozite është prezantimi i qenit ilir – racë autoktone e Sharrit, ruajtja dhe kultivimi i racës së pastër të qenve të rajonit tonë, në mënyrë që qytetarët të njihen me vetitë dhe karakteristikat e tyre.

Ky aktivitet është në harmoni të plotë me priorititetet zhvillimore komunale dhe do të kontribuojë drejtëpërdrejt në ruajtjen e traditave të kultivimit të racës së pastër autoktone të qenve të Sharrit.

Objektivat:

- Të ndikojë në ruajtjen dhe kultivimin e racës së pastër autoktone të qenit ilir - qenit të Sharrit;
- Përmirësimin e gjendjes së promovimit të racës autoktone të qenve të Sharrit;
- Të sensibilizohet popullata për vlerat e kultivimit të racës autoktone të qenve të Sharrit dhe cilësitë e tyre;
- Promovim direkt përmes mediave elektronike dhe të shkruara;

Përfituesit:

Përfitues në mënyre të drejtëpërdrejtë do të janë fermerët, kultivuesit lokal - tradicional të racës autoktone të qenit ilir të Sharrit në Komunën e Dragashit, ku ata do të ekspozojnë - defilojnë qentë e tyre, kurse në mënyrë indirekte komuniteti në përgjithësi, ku do të kenë rastin të njoftohen me kultivuesit tradicionalë të qenit të Sharrit.

Pjesëmarrësit

Në këtë Ekspoze është planifikuar të marrin pjesë:

- Fermerët apo kultivuesit për ekspozimin e qenve të tyre të racës së pastër të qenit ilir - qenit të Sharrit nga Komuna e Dragashit.

Buxheti

Për organizimin – mbajtjen e Ekspozesë se qenve ilirë - të Sharrit është planifikuar buxhet:
3000 (tre mijë) euro.

Data e organizimit dhe lokacioni:

Kjo Ekspoze do të organizohet gjatë Festivalit Ballkanik të Vallevë “Opoja Vallëzon” në **Brodosanë, në vendin: Oborri i Shkollës “28 Nëtori”.**

Aktivitetet që do të kryhen:

- Njoftimi i kultivuesve për organizimin e Ekspozesë së qenit ilir - qenit autokton të Sharrit;
- Përgatitja e vendit për mbajtjen e Ekspozesë së qenve dhe t'u krijohen kushte pjesëmarrësve që para fillimit t'i vendosin qentë e tyre;
- Kultivuesit e qenit ilir - të Sharrit duhet të vishen me rroba tradicionale kombëtare;
- Kultivuesit e qenit ilir - të Sharrit duhet të dëshmojnë me certifikatë për vaksinimin e qenve të tyre;
- Defilimi i qenve;
- Formimi i Komisionit Profesional, i cili ka për detyrë të bëjë vlerësimin e racës autoktone të qenve të Sharrit;
- Ndara e shpërblimeve;
- Përfituesi i Thirjes publike duhet të përgatit materialet promovuese: banerin me mbishkrim “Ekspozita e racë së qenit ilir - të Sharrit me dimensione 4 m/1.5 m, në të dy gjuhët, me logo të Komunës;
- Ekspozeja të jetë e hapur së paku 2 orë (një ditë);
- Të njoftohen mjetët e informimit për mbajtjen e këtij aktiviteti;

Organizatat përfituese:

Përfituese do të jetë **një organizatë joqeveritare.**

Kushtet për aplikim:

- Të drejtë të aplikimit kanë OJQ-të që janë te regjistruala në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit dhe të cilat merren me aktivitete në përkrahje dhe ruajtje të racë së qenit ilir - qenit të Sharrit;

- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e aplikimit;
- OJQ-të të kenë të kryer transaksione financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë të përbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit;
- Propozimi-Aplikacioni duhet të dorëzohet i detajur në formularët e paraparë të cilët, bashkë me udhëzimet për aplikonte, janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunës së Dragashit;
- Do të konsiderohën për t'u vlerësuar vetëm projektet e dorëzuara brenda afatit të paraparë me Thirrje publike;
- OJQ-të në kuadër të kësaj Thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt;
- Kohën dhe mënyrën e ankesave i gjeni të detajuara në udhëzimet për aplikantë të Thirrjeve publike.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Aplikacioni-projekt propozimi;
- Formulari i propozim-buxhetit (specifikacioni);
- Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (sipas Rregullores nr.04/2017- Financimi i OJQ-ve- MF – Neni 10, Paragrafi 1.4 dhe 1.5);
- Formulari për konflikt interesë (sipas Rregullores nr.04/2017- Financimi i OJQ-ve - MF – Neni 10, Paragrafi 1.4 dhe 1.5);
- Dokumenti i identitetit i aplikuesit (fotokopje);
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje);
- Konfirmimi bankar i OJQ-së;
- Të specifikojet agjenda e aktiviteteve;
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (periudha e fundit tatimore);
- Dëshmi të implementimit të projekteve/programeve të ngjashme;
- Dëshmi për kryerjen e obligimeve paraprake nga mbështetja financiare publike.

Vlerësimi

Vlerësimi do të bëhet nga Komisioni Profesional prej 5 antarësh, të cilët do t'i vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve për vlerësim dhe sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret për Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Po ashtu vlerësimi do të bëhet edhe sipas:

- Plotësimit të kushteve administrative të aplikimit;
- Ndërlidhja më objektivat e Thirrjes;
- Kapaciteti i dëshmuar organizativ dhe menaxhues;
- Cilësia dhe originaliteti i projektit;
- Buxhetimi i specifikuar dhe real.

Kohëzgjatja e aplikimit

Aplikimi do të fillojë më datë **19/06/2024** deri më **03/07/2024 (15 ditë)**.

Vërejtje:

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Protokollit (Arkivi) Nr.1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për: Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural!

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtim të aplikacioneve!

Për çdo informatë-sqarim lidhur me aplikimin, mund të kontaktoni në DBPITZHR!

